

P Z A P
I P Ž P



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1130/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vjosa Gashi, kandidate për anëtare të kuvendit komunal, në Prizren, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionerve të Vendvotimit (KVV), Prizren për shkak të parregullsisë gjatë procesit të numërimit, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e parregullt ankesa e Vjosa Gashi, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Prizren nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013, nga Vjosa Gashi, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Prizren nga subjekti politik (LDK), në të cilën pretendon se duke i kontrolluar rezultatet e numërimit të votave në KQZ – Prizren, në zyrën e LDK-së në Prizren dhe KQZ- Prishtinë, kam hasur në tri rezultate të ndryshme 182 vota, 191 vota dhe 181 vota, kjo sipas parashtreesit të ankesës është parregullsi, më tutje vazhdon se në Vendvotimin 2025/A, në një procesverbal i marrun në zyrën e LDK-Prizren më figuruan vetëm në një kuti 77 vota, ndërsa në procesverbalin që e posedon KQZ-ja në Prizren nuk figurojnë, pra nëse është bërë gabim, atëherë i njëjtë gabim ka mund me ndodhë edhe me votat e mijë. Në procesverbalin e vendvotimit 2007/A dhe 2008/A i kam 105 vota dhe 67 vota, këto procese janë zhdukur nuk kam mundur ti gjej më, në vendvotimin 2009/A më kan dal të pavlefshme 105 vota – gjë që po dyshoj shumë, pasi që familjarët e mi votojnë në këtë vend.

PZAP-i, shqyrtoi ankesën, gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lëndës PZAP-i, konstaton se ankesa është e parregullt përfaktin se formulari i ankesës nuk përmbrush kushtet e parapara në bazë të nenit 3.6 pikë d) të

Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e ku thuhet se të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese, vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës, andaj për këtë arsyе duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

A nr.1130/2013 më datën 06.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Këshillë juridike: *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*